



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

RIORGANIZIMIN E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE, NDËRMARRJES SË GJELBËRIMIT DHE KRIJIMIN E AGJENCISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, 1.6, shkronja “b”, neni 23, pika 5,7,8,9, neni 54, shkronja “d” neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr.10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar; Vendimit nr. 827, datë 15.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë “Miratimin e Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në Varësi të Bashkisë Berat” i ndryshuar ; VKB nr. 81, datë 29.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Berat për Vitin 2021 dhe PBA përfundimtar 2021-2023, me propozim të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Të miratojë krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Publike si institucion në varësi të Bashkisë Berat. Detyrat kryesore funksionale të këtij institucioni do të jenë si më poshtë vijon :
 - a) Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
 - b) Ndriçimin e mjediseve publike brenda territorit të Bashkisë Berat.
 - c) Administrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve memoriale (Varrezat e Dëshmorëve) dhe rehabilitimin e mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit brenda territorit të Bashkisë Berat.
 - d) Shërbimin e dekorit publik.
 - e) Administrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve, lulishteve dhe hapësirave publike brenda territorit të Bashkisë Berat që nuk përfshihen në kontratën e pastrimit.
 - f) Administrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të transportit (mjeteve të punës).
2. Efektet financiare të këtij vendimi do të fillojnë nga data 01.01.2022.
3. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi, njësia shpenzuese Ndërmarrja e Gjellbërimit do të mbaroj funksionin si person juridik dhe do të përthithet nga Angjencia e Shërbimeve Publike. Njësia shpenzuese Drejtorina e Shërbimeve Publike do të riorganizohet dhe funksionet e saj do t'i kalojnë Angjencisë, kjo e fundit do të funksionojë sipas NIPT të Drejtorisë së Shërbimeve. Strukturat përgjegjëse në bashki i paraqesim vendimin për miratim Kryetarit të Bashkisë, pas marrjes së këtij vendimi.

4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Gjellbërimit për ndjekjen e procedurave të bashkimit të aseteve, mjeteve të punës, inventarit fizik, ambienteve dhe arkivës së ndërmarrjeve në procesin e krijimit të Agjencisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Ndërmarrja e Gjellbërimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Berat

K R Y E T A R

I K Ë S H I L L I T B A S H K I A K

Ervin CECA

